



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 40  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302  
Prishtinë, më 25 prill 2019, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Enver Hoti, Naser Rugova, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Bekim Haxhiu, Fikrim Damka dhe Time Kadrijaj.

**Munguan:** Miljana Nikoliq, Drita Millaku, Haxhi Avdyli dhe Flora Brovina.

**Pjesëmarrës tjerë:** Ilir Hoxha – KDI, Faruk Kukaj – HANDIKOS, Ibadete Dili – HANDIKOS, Shefki Kastrati – NDI, Drenushë Maxhuni – KOHA DITORE, Elvanda Gojani – KIO-AMC, Mirlinda Zhushi – LDK, Ylli Sokoli dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi:** Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

**RENDI I DITËS:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 10.04.2019;**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të monitorimit, zbatimi i Ligjit nr. 04/L-190, për Produkte dhe Pajisje Medicinale;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 10.04.2019**

Procesverbali, i mbledhjes së datës 10.04.2019, u miratua pa asnjë ndryshim.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të monitorimit, zbatimi i Ligjit nr. 04/L-190, për Produkte dhe Pajisje Medicinale**

**Kryetarja** tha se më 24.10.2018, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit, komisioni ka marrë iniciativën për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale, ku është formuar grupi punues, i cili është marrë me monitorimin e këtij ligji. Kryesues i grupit punues ka qenë Naser Rugova dhe anëtarët e tjerë të grupit punues kanë qenë deputetët Besa Baftiu, Bekim Haxhiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka. Ky grup punues ka vizituar të gjithë aktorët të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë janë përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Ajo tha se raporti është përpiluar dhe dërguar me kohë nga stafi. Ajo bëri thirrje për rekomandime dhe sugjerime nga anëtarët e Komisionit përpara se të miratohet raporti dhe para se të procedojë në seancën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mënyrë që edhe deputetë të tjerë të inkorporohen në debat dhe që Ministria e Shëndetësisë të ketë për bazë këtë raport në mënyrë që ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale të ndryshohet.

**Fatmire Mulhaxha-Kollçaku** tha se e miraton këtë raport, dhe se rekomandimi i parë që të hartohet një ligj i ri i përmbush të gjitha gjetjet nga monitorimi.

**Naser Rugova** tha se ky raport është substancial dhe është i kompletuar në të gjitha aspektet si në strukturë, në përmbajtje dhe në konkluzion. Ai tha se te rekomandimet ka vend për disa përmirësime kozmetike. Duke qenë se rekomandimi i parë ndërthet në vete përmbajtjen kryesore, ai mendon se Ministria e Shëndetësisë duhet të hartojë një ligj të ri, apo dy ligje të veçanta, njëri për produkte dhe tjetri për pajisje medicinale. Ai tha se ky rekomandim mund t'i lihet seancës që të vendosë për miratim. Ai po ashtu sugjeroi se rekomandimet duhet të strukturoren në mënyrë më koncize kështu që në seancë të shkojmë me rekomandime konkrete.

**Time Kadrijaj** tha se ka shumë nevojë që të përpilohet një ligj i ri. Sipas saj aprovimi i ligjit që tani është në fuqi është degraduar në seancën plenare me amendamente për shkak të disa inateve politike. Ajo tha se është e pakuptimtë se si mund të funksionojë Agjencia me këtë ligj, pasi që shumë pika të këtij ligji janë të pa implementueshme. Ajo tha se ky ligj nuk është dashur të votohet, por të tërhiqet pasi që inatet politike kanë shkaktuar mosfunksionimin e ligjit.

**Kryetarja** tha se duhet të qartësohet se a rekomandojmë të shkojmë me një ligj apo me dy ligje, pra të bëhet ndryshimi, të votohet në mënyrë që stafi ta përmirësojë dhe më pas raporti të del në seancë për votim.

**Naser Rugova** tha se duhet të bëhen dy ligje duke nënkuptuar kështu numrin e udhëzimeve administrative, pasi që po prodhojmë ligje të cilat janë të mira, mirëpo ka vështirësi në implementimin e tyre. Ai mendon se duhet të bëhen dy ligje duke u rregulluar kështu në

mënyrë precize dhe të saktë fushat në fjalë dhe të zbutet barra e hartimit të udhëzimeve administrative.

**Kryetarja** tha se edhe ajo pajtohet që të bëhen dy ligje pasi që monitorimi i pajisjeve nuk është bërë në mënyrë korrekte, vetëm produktet medicinale në disa raste kanë pas një mbikëqyrje më të mirë, ndërsa pajisjet fare. Ka kërkesë që disa prej ligjeve të fuzionohen dhe të bëhet një kontroll më cilësor e pajisjeve medicinale.

Pas diskutimeve, komisioni njerëzit miratoj Raportin për Mbikëqyrje e zbatimit të Ligjit për Produkteve dhe Pajisjeve medicinale.

#### **4. Të ndryshme**

**Time Kadrijaj** së pari falënderoi stafin mbështetës për korrektësinë për ti informuar për aktivitete apo takime si me email, po ashtu edhe me sms. Ajo tha se nuk i ka rastisur në asnjë legjislacion që të anulohet takimi në mëngjes pasi që nuk është praktikë e mirë, sepse të gjithë kanë obligime dhe angazhime. Ajo tha se aktivitetet nuk duhet të anulohen aty për aty, mirëpo së paku një ditë më herët.

**Kryetarja** u pajtua me mendimin e deputetes Time Kadrijaj, duke shtuar se stafi nuk është përgjegjës për gjëra të tilla pasi që ata rekomandohen nga deputetët. Ajo çka dallon mes grupeve punuese dhe Komisionit është se grupet punuese mund të mbahen edhe me vetëm dy anëtarë. Kërkon që kjo të mos ndodhë herëve të tjera.

**Enver Hoti** falënderoi stafin mbështetës për punën dhe tha se nuk është diçka e madhe që është anuluar takimi i grupit punues. Ai shpjegoi se ka kërkuar që të informohen deputetët për anulim të takimit së paku në orën 8 të mëngjesit. Arsyeja e shtyrjes së takimit ka qenë për shkak të deputetes Drita Millaku dhe kryesuesi i grupit të KES, Enver Hoti kërkoi falje në emër të grupit punues, si dhe të deputetes Millaku. Ai shtoi se i merr më shumë seriozitet dhe përgjegjësi kërkesat të cilat vijnë nga ana e opozitës. Ai është pro kushteve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit pasi që të gjithë janë pjesë e komisionit dhe si të tillë duhet të japin kontributin e tyre.

**Kryetarja** tha se në mbledhjen e fundit kemi shprehur gatishmërinë t'i vizitojmë disa institucione, prandaj ju ftoi që të jeni prezent te këto vizita.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

**E përgatiti:**

***Stafi mbështetës i komisionit.***

**Kryetarja e komisionit,**

---

**Besa BAFTIU**